



PARIMET E IOPS-SË PËR
MBIKËQYRJEN PENSIONALE
PRIVATE

Nëntor 2010

ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E MBIKËQYRËSVE PENSIONALË (IOPS)

PARIMET E IOPS-SË PËR MBIKËQYRJEN PENSIONALE PRIVATE



PARIMET E IOPS-SË PËR MBIKËQYRJEN PENSIONALE PRIVATE

Preambulë

1. Parimet e IOPS-së për mbikëqyrjen pensionale private u miratuan për herë të parë në vitin 2006. Ky dokument i përmban Parimet e reviduara, të miratuara në vitin 2010.

2. Qëllimet e mbikëqyrjes pensionale private fokusohen në mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe shfrytëzuesve të fondeve pensionale, nëpërmjet përparimit të stabilitetit, sigurisë dhe menaxhimit të mirë të fondeve pensionale. Mbikëqyrja pensionale përfshin mbikëqyrjen e institucioneve pensionale dhe zbatimin dhe përparimin e harmonizimit me rregullativën lidhur me strukturën dhe punën e fondeve dhe planeve pensionale, me qëllim të promovimit të sektorit pensional që funksionon mirë. Pavarësisht kësaj, arritja e stabilitetit brenda sektorit pensional është një pjesë e rëndësishme e sigurimit të stabilitetit të sistemit financiar në tërësi (pasi investimet e bëra nga fondet pensionale kanë ndikim të madh në ekonominë reale në shumë vende). Mbikëqyrja pensionale duhet ta ketë parasysh novacionin financiar.

3. Sigurimi i pensioneve ka rëndësi thelbësore ekonomike dhe sociale, duke siguruar kështu dërgimin e suksesshëm të të ardhurave pensionale adekuate. Mbikëqyrja efektive e pensioneve dhe e institucioneve që ofrojnë produkte dhe shërbime pensionale është e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e konsumatorëve - detyrë e domosdoshme me çdo produkt financiar që shitet për joprofesionistët. Mbikëqyrja pensionale është e nevojshme për të arritur shkallën e mbrojtjes së nevojshme për të mbështetur kursimet e menaxhuara privatisht dhe është mjet i cili ndihmon që pensionet të përshtaten me rreziqet e tregut. Rreziqet e tilla mund të jenë veçanërisht problematike lidhur me pensionet për shkak të karakteristikave të këtyre produkteve financiare, të tilla si:

- karakteri afatgjatë i kontratave të përfshira dhe nevoja pasuese për stimulime ose edhe nevoja për të tejkaluar "shkurtpamësinë" personale në aspekt të kursimit afatgjatë;
- mbulimi i tyre në fushëveprimin e gjerë social dhe ekonomik të popullsisë (veçanërisht aty ku ekzistojnë stimulimet ose nevojat për "shkurtpamësi");
- toleranca ndaj rrezikut të ulët tek anëtarët dhe shfrytëzuesit e pensionit, për arsye se bëhet fjalë, kryesisht, për çështje mbijetese se sa për kursim të padetyrueshëm;
- kompleksiteti i produkteve, në të cilat ka edhe çështje në fushën e tatimeve, supozime për rrogat e ardhshme, jetëgjatësinë, vështirësitë në rregullimin e mjeteve dhe detyrimeve, etj. - kompleksiteti që e tejkalon arsimimin financiar të shumicës së investitorëve dhe që inkurajon informacione asimetrike midis ofruesve të pensioneve ose ndërmjetësuesve dhe shfrytëzuesve financiarë;
- ndonjëherë konkurrenca dhe zgjedhja e kufizuar, me ç'rast vendimet shpeshherë miratohen kolektivisht nga punëdhënësit ose sindikatat;
- ndikimi i tyre potencial në tregun financiar dhe stabilitetin ekonomik duke pasur parasysh madhësinë e tyre që gjithnjë është në rritje për sa u përket tregjeve financiare dhe BPV-së së vendeve;
- roli i tyre "social" dhe financiar, i cili po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, duke pasur parasysh se reformat në shumë vende u japin rëndësinë më të madhe pensioneve private (nëpërmjet lehtësimeve tatimore dhe politikës tjetër publike), për faktin se popullsia e moshuar në disa raste bëjnë që sigurimi social të jetë barrë në rritje për resurset qeveritare, duke çuar në uljen e pensioneve shtetërore;

- ritmi i shpejtë i novacionit financiar që krijon produkte të reja dhe të pakontrolluara financiare;
- rritja e kompleksitetit dhe sofistikimit të kimit financiar.

4. Në kontekst të të lartpërmendurës, mbikëqyrja pensionale përballë me sfida unike: për nga **vëllimi**, për shkak të numrit të madh të fondeve ose planeve pensionale nën mbikëqyrje, numrit të anëtarëve dhe shfrytëzuesve, llojeve të ndryshme të produkteve pensionale dhe faktit se ndoshta mbikëqyrja duhet të koordinohet ndërmjet sektorëve për shkak të karakterit të ndryshëm të institucioneve që ofrojnë pension; si dhe për sa i përket thellësisë së **detajeve** të mbikëqyrjes që nevojitet për shkak të ndjeshmërisë së anëtarëve dhe shfrytëzuesve dhe, në shumë raste, për shkak të karakterit të detyrueshëm të sistemit.

5. Megjithëse mbikëqyrja pensionale ka shumë aspekte unike, IOPS-ja pranon se shumë mbikëqyrës pensionalë punojnë në struktura të integruara mbikëqyrëse financiare dhe për këtë arsye është e rëndësishme që këto parime të jenë në përputhje me parimet ndërkombëtare që i mbulojnë institucionet e tjera të shërbimeve financiare. Prandaj, IOPS-ja do të konsultohet me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Fushëveprimi dhe mbulimi

6. Parimet e IOPS-së të mbikëqyrjes pensionale janë bërë për t'i mbuluar planet pensionale profesionale dhe personale dhe/ose fondet pensionale¹. Mbikëqyrja pensionale përfshin ndjekjen e aktiviteteve të planeve dhe fondeve pensionale për t'u siguruar që ato mbesin brenda kërkesave të kornizës rregullore, përkatësisht që në thelb janë në përputhje me rregullat². Aktivitetet e mbikëqyrjes ndryshojnë në varësi të mjedisit rregullator dhe juridik, zgjedhjeve të politikave dhe shumë faktorëve të tjerë. Në përgjithësi, mund të përkufizohet se këto ndikojnë mbi ndryshimet në sigurimin e pensioneve që kontribuon në arritjen e qëllimeve të mbikëqyrjes pensionale, pa dallim qoftë nëpërmjet ndërhyrjes së drejtpërdrejtë ose udhëzimeve. Fushëveprimi i mbikëqyrjes mund të përfshijë çdo aktivitet mbikëqyrës i cili fillimisht merret me sigurimin e kërkesave dhe kufizimeve të vendosura ndaj fondeve pensionale ose planeve të cilave u përmbahen³.

¹Parimet nuk vlejnë për ato plane pensionale dhe fonde pensionale në vendet e Bashkimit Evropian që janë jashtë fushëveprimit të Direktivës 2003/41/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit më 3 qershor 2003 mbi aktivitetet dhe mbikëqyrjen e institucioneve për sigurimin pensional profesional (për shembull, pensionet e financuara përmes rezervave në kontabilitetin e firmave).

Parimet nuk i përfshijnë kontratat e sigurimit si të tilla (megjithëse ato mund të përdoren si në planet pensionale profesionale, ashtu edhe në ato personale). Parimet për mbikëqyrjen e sigurimit sigurohen nga Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimit: "*Parimet themelore dhe metodologjia e sigurimit*" – shih <http://www.iaisweb.org/358coreprinciplesmethodologyoct03revised.pdf>

Edhe pse këto udhëzime u referohen fondeve pensionale private, mund të jetë gjithashtu praktikë e mirë të zbatohen standarde të ngjashme për fondet qeveritare.

Sipas taksonomisë së OECD-së, fondi pensional është grup i ndarë ligjërish i mjeteve që formon person juridik të pavarur që blihet me kontributet e planit pensional, me qëllimin e vetëm të financimit të përfitimeve të planit pensional. Anëtarët e planit/fondit kanë të drejtë ligjore ose të drejtën e përdoruesit ose ndonjë kërkesë tjetër kontraktuese të mjeteve nga fondi pensional. Fondet pensionale marrin formën e subjektit për qëllime të veçanta dhe aftësi pune (si për shembull, trusti, fondacioni ose subjekti korporativ) ose fondi i veçuar ligjërish pa aftësi pune të menaxhuar nga ofruesi i përkushtuar (shoqëria për menaxhimin e fondeve pensionale) ose institucioni tjetër financiar në emër të anëtarëve të planit/fondit.

Plani pensional është kontratë e detyrueshme juridikisht me qëllimin eksplicit të daljes në pension (ose - me qëllim të përmbushen kushtet tatimore ose dispozitat e kontratës - përfitimet nuk mund të paguhen fare ose pa dënim të konsiderueshëm, përveç nëse shfrytëzuesi është më i vjetër se moshë e caktuar për daljen në pension). Kjo kontratë mund të jetë pjesë e kontratës më të gjerë të punësimit, e cila mund të theksohet në rregullat ose dokumentet e planit ose mund të kërkohej në pajtim me ligjin. Përveç faktit që kanë qëllim eksplicit të daljes në pension, planet pensionale mund të ofrojnë përfitime shtesë, si për shembull, përfitime për arsye të aftësisë së kufizuar, sëmundjes dhe personave të mbijetuar.

²Rregullimi i pensioneve përfshin aktivitete që kanë si qëllim të përbashkët përcaktimin e formës, rregullave dhe standardeve që do t'i përkufizojnë organizimet dhe aktivitetet e lejuara, duke konstatuar në thelb parametrat brenda të cilëve u kërkohej të funksionojnë institucionet. Parimet e rregullimit të pensioneve parashihen me OECD: "*Parimet themelore të rregullimit të pensionit profesional*" - shih <http://www.oecd.org/dataoecd/14/46/33619987.pdf> Parimet e IOPS-së përbëjnë një pjesë themelore të standardit të OECD-së, të njohur dhe të zbatuar nga OECD-ja.

³Sipas akteve nënligjore të IOPS-së, mbikëqyrja përfshin kryesisht çështje të organizimit, strukturës dhe funksioneve të trupit mbikëqyrës, zhvillimin e teknikave të duhura të mbikëqyrjes dhe zbatimin e rregullave të aplikueshme nga trupat mbikëqyrës.

7. Trupat që kryejnë mbikëqyrje pensionale të theksuara në Parimet përkufizohen si çdo subjekt përgjegjës tërësisht ose pjesërisht për mbikëqyrjen e fondeve, planeve, skemave ose aranzhmaneve pensionale në vend ose pjesë të vendit, pavarësisht nëse janë persona juridikë të veçantë ose jo. Parimet janë dizajnuar për të përfshirë lloje të ndryshme të strukturës mbikëqyrëse (të specializuara, pjesërisht të integruara dhe të integruara). Produktet pensionale, gjithashtu, vijnë në forma shumë të ndryshme (kontributi i përcaktuar kundrejt përfitimit të përkufizuar, i detyrueshëm kundrejt atij vullnetar, etj.), ndërsa sistemet pensionale të vendeve, gjithashtu, dallohen shumë, pasi formohen nga shumë faktorë (nga karakteri i shtetit, deri te niveli i zhvillimit ekonomik dhe struktura pensionale e tregut). IOPS-ja ka marrë parasysh diversitetin e tillë dhe ka për qëllim me këto Parime të identifikojë praktikën e mirë që mund të zbatohet në korniza globale.

Parimi 1: Qëllimet

Ligjet kombëtare duhet të caktojë qëllime të qarta dhe eksplicite për trupat e mbikëqyrjes pensionale

1.1 Qëllimet strategjike kryesore të trupit të mbikëqyrjes pensionale duhet të përcaktohen qartë dhe publikisht. Ato duhet të përfshijnë fokusin në mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe shfrytëzuesve të pensioneve. Qëllimet duhet të synojnë gjithashtu stabilitetin dhe sigurinë e fondeve dhe planeve pensionale, qëndrueshmërinë e sektorit pensional në tërësi, përparimin e menaxhimit të mirë dhe inkurajimin e sigurimit të pensionit.

1.2 Përgjegjësitë e mbikëqyrësit pensional duhet të theksohen qartë dhe objektivisht, të japin autorizime të qarta dhe të caktojë detyra konkrete.

Parimi 2: Pavarësia

Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të kenë pavarësi operative

2.1 Trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të ketë pavarësi operative nga përzierja e organeve politike dhe komerciale në kryerjen e funksioneve dhe autorizimeve të tij⁴.

2.2 Për të siguruar pavarësinë, është veçanërisht e nevojshme stabiliteti dhe autonomia e drejtorëve të nivelit të lartë në trupin e mbikëqyrjes pensionale. Nominimi, emërimi dhe ndërrimi i udhëheqësit të trupit të mbikëqyrjes pensionale duhet të bëhet përmes procedurave eksplicite dhe mekanizmave transparentë. Udhëheqësi i trupit të mbikëqyrjes pensionale zakonisht emërohet për kohë të caktuar (zakonisht midis 3-6 vjet), me riemërim të mëtejshëm të lejuar (me qëllim që të mbahen praktikuesit e aftë).

2.3 Trupi i mbikëqyrjes pensionale, gjithashtu, duhet të financohet në mënyrë që do të sigurojë pavarësi dhe duhet të ekzistojë procesi buxhetor transparent.

2.4 Aktet mbikëqyrëse, duke përfshirë edhe përdorimin e autorizimeve për realizim dhe sanksionim, mund të kontestohen vetëm me vendim gjyqësor, duke përfshirë edhe tribunatet me autorizime relevante ose përmes procesit parlamentar.

⁴Pavarësia operative nënkupton se trupi mbikëqyrës menaxhon dhe miraton vendime në mënyrë autonome në nivel ditor. Në nivel më të lartë, të orientuar drejt politikës, janë të mundshme ndikimet politike dhe qeveritare kombëtare mbi agjencitë mbikëqyrëse, jashtë kontrollimit të tyre. Mund të ketë fazë të mesme kur nevojitet miratimi i ministrisë për të zbatuar aktivitetet që përfshijnë heqjen ose çregjistrimin e pjesëmarrësit të industrisë.

Parimi 3: Resurset përkatëse

Trupat e mbikëqyrjes pensionale kanë nevojë për resurse financiare, njerëzore dhe resurse të tjera përkatëse

3.1. Trupave të mbikëqyrjes pensionale duhet t'u caktohet personaliteti adekuat dhe qasja në resurset⁵.

3.2. Trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të ketë buxhetin e vet, të mjaftueshëm për t'i mundësuar të zbatojë mbikëqyrje proporcionale, efektive dhe të pavarur. Financimi, pjesërisht ose i plotë, i trupit të mbikëqyrjes pensionale nga fondet ose planet pensionale të mbikëqyrura mund të merret parasysht, me kusht që të ruhet pavarësia. Në rastet kur arkëtohet kompensimi, struktura e kompensimit duhet të jetë transparente.

3.3. Trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të punësojë, trajtojë dhe mbajë personalitetin të mjaftueshëm me standarde dhe ekspertizë të lartë profesionale, duke përfshirë edhe standardet përkatëse të konfidencialitetit dhe zbulimit të informacioneve.

3.4. Drejtorët, udhëheqësit e trupit të mbikëqyrjes pensionale dhe udhëheqësia e lartë duhet të jenë të kualifikuar siç duhet, me arsim, përvojë, kapacitet dhe reputacion të mjaftueshëm.

3.5. Nëse kapacitetet e trupit të mbikëqyrjes pensionale janë të pamjaftueshme, ose për arsye të tjera konsiderohen të domosdoshme, trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të ketë autorizim për të autorsuar detyrat mbikëqyrëse të palëve të treta (p.sh. revizorët, aktuarët) ose për të angazhuar ("huazojnë") personalitetin me përvojë të përshtatshme të punojë brenda, me ç'rast trupi i mbikëqyrjes pensionale mbetet përgjegjës për procesin dhe vendimet mbikëqyrëse. Në rastet kur funksionet e mbikëqyrjes pensionale u autorsohen palëve të treta, trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të jetë në gjendje të sigurojë nivelin e nevojshëm të konfidencialitetit, të vlerësojë kompetencën e tyre, të ndjekë suksesshmërinë e tyre dhe të sigurojë pavarësinë e tyre nga fondi pensional ose persona të tjerë të ndërlidhur, me qëllim që t'u shmangët konfliktit të interesave. Nëse është e nevojshme, trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të ketë aftësinë për të ndërmarrë veprime kundër këtyre palëve të treta drejtpërdrejt ose nëpërmjet trupit profesional përkatës. Miratimi i vendimeve dhe zbatimi i sanksioneve, brenda fushëveprimit të mbikëqyrësit pensional, nuk duhet të autorsohet.

Parimi 4: Autorizimet përkatëse

Trupave të mbikëqyrjes pensionale duhet t'u jepen autorizimet e nevojshme hetimore dhe zbatuese për t'i përmbushur funksionet e tyre dhe për t'i arritur qëllimet e tyre

4.1. Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të jenë të autorizuar ligjërisht për të ushtruar mbikëqyrjen dhe duhet t'u jepen autorizimet dhe kapacitetet përkatëse për t'i praktikuar këto autorizime⁶.

4.2. Trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të ketë autorizim për t'i ushtruar funksionet e domosdoshme të mbikëqyrjes, sipas karakterit të sistemit pensional mbi të cilin bëhet mbikëqyrja. Mbikëqyrja efektive e fondeve ose planeve pensionale duhet të fokusohet në harmonizimin ligjor, sigurinë dhe kontrollimin financiar, kërkesat kapitale minimale, aktivitetin investues, menaxhimin e mirë dhe integritetin, ekzaminimin aktuar, menaxherët për mbikëqyrjen e planeve ose fondeve pensionale dhe zbulimin përkatës të informacioneve të anëtarëve. Autorizimet duhet të mundësojnë kryerjen e inspektimeve relevante në terren dhe jashtë terrenit.

4.3. Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të kenë autorizime gjithëpërfshirëse hetimore dhe zbatuese.

⁵Për më shumë detaje shih *Udhëzimet e IOPS-së për ndërhyrjen mbikëqyrëse, zbatimin dhe sanksionet* <http://www.iopswb.org/dataoecd/47/40/43972432.pdf> dhe *Udhëzimet e IOPS-së për vlerësimin mbikëqyrës të fondeve pensionale* <http://www.iopswb.org/dataoecd/38/47/41042660.pdf?contentId=41042661>

⁶Për më shumë detaje shih *Udhëzimet e IOPS-së më lartë*

Korniza juridike që i përcakton kushtet dhe rrethanat në të cilat mbikëqyrësi i fondeve pensionale duhet të ndërhyjë, duhet të jenë mjaft fleksibile për t'i mundësuar mbikëqyrësit pensional të ndërmarrë veprime parandaluese, mbrojtëse ose ndëshkuese.

4.4 Trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të ketë autorizim të zbatojë hetim të plotë kur ekziston dyshimi për ose vërehet problemi i caktuar, duke i obliguar fondet dhe palët e tjera relevante (siç janë menaxherët e mjeteve, kujdestarët, revizorët) t'i vënë në dispozicion dokumentet dhe informacionet. Autorizimet e nevojshme përfshijnë aftësinë për t'i vendosur masat korrektive dhe masat korrigjuese nëse nuk zbatohen urdhrat e trupit. Fushëveprimi i autorizimeve mund të zgjerohet nga fuqia për të vendosur sanksionet administrative siç janë dënimet, deri te menaxhimi i drejtpërdrejtë, heqja e licencave dhe t'u referojë çështjeve për ndjekjen penale. Në disa raste, autorizimet mund të përfshijnë aftësinë për të lëshuar rregullativën obliguese.

4.5 Trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të ketë qëllime mbikëqyrëse strategjike të qarta dhe të përkufizuara mirë për përdorimin e autorizimeve të ndërhyrjes, zbatimit dhe sanksionimit, duke përcaktuar qartë nëse qëllimi i aktivitetit të tyre është parandalues, mbrojtës ose ndëshkues dhe në mënyrë përkatëse t'i përdor veglat dhe autorizimet përkatëse. Trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të ketë politikë koherente, të menduar mirë për të vendosur për kombinimin e veglave mbikëqyrëse dhe aftësinë për të përshtatur këtë qasje në rastin e rrethanave të ndryshueshme.

4.6 Është i nevojshëm gradimi i mjaftueshëm i autorizimeve për t'i mundësuar trupit mbikëqyrës që në mënyrë përkatëse të përshtatë përgjigjen e tij dhe autorizime të mjaftueshme ndëshkuese për të kryer aktivitetin.

4.7 Edhe pse nuk mund "në mënyrë aktive" të përdoren të gjitha autorizimet, trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të ketë autorizime të caktuara ose të përdoren në rrethana të jashtëzakonshme – duke shmangur kështu anulimet që marrin mjaft kohë në veprimin me trupat e tjerë mbikëqyrës ose, duke vepruar si pengesë, mund të shërbejnë për të ndryshuar sjelljen e subjekteve të mbikëqyrura.

4.8 Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të kenë autorizimin për të ndërmarrë masa të jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme, në kohë vështirësish të shpeshta financiare dhe ekonomike dhe/ose paqëndrueshmërie (për shembull në rast të kërkesave të shtuara për njoftime, forcimit të testeve të stresit ose pezullimit të përkohshëm të kërkesave të caktuara rregullatore ose mbikëqyrëse që mund të kenë ndikim prociklik dhe negativ në tregjet financiare në afat të shkurtër).

Parimi 5: Mbikëqyrja e bazuar në rrezik⁷

Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të miratojnë qasje të bazuar në rrezik

5.1 Me qëllim që në mënyrë efikase t'i përdorin resurset e tyre, trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të miratojnë qasje të bazuar në rrezik dhe duhet të përcaktojnë metodologji përkatëse për vlerësimin e rrezikut⁸.

5.2 Lëvizja drejt mbikëqyrjes së bazuar në rrezik mund të bëhet gradualisht, duke e kombinuar këtë teknikë me mbikëqyrjen të bazuar në rregullat më tradicionale, sikur që trupi mbikëqyrës dhe industria pensionale e zhvillojnë ekspertizën e nevojshme.

5.3 Futja e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik duhet të shihet si lëvizje e vazhdueshme nga njëri ekstrem i mbështetjes së plotë në sistemin e bazuar në rregullat deri në ekstremin tjetër ku theksi i mbikëqyrjes është funksioni ose rreziku. Mbikëqyrja e bazuar në rrezik nuk do të thotë se nuk ka rregulla ose procedura të harmonizimit.

5.4 Nevojitet kornizë juridike që lejon diskrecionin adekuat në interpretimin dhe ushtrimin e autorizimeve mbikëqyrëse, i cili gjithashtu duhet t'u sigurojë trupave të mbikëqyrjes pensionale autorizime të domosdoshme për të miratuar qasje të bazuar në rrezik.

5.5 Riorganizimi dhe trajnimi i personalit, për sa i përket filozofisë dhe procesit të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, duhet të ndërmerret në të njëjtën kohë me tranzicionin në qasjen e re.

5.6 Trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të komunikojë qasjen e tij të bazuar në rrezik në industrinë pensionale, duke shpjeguar se çfarë pritet prej tij, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut, nëpërmjet shënimeve me udhëzime dhe eventualisht ofrimit të trajnimeve.

5.7 Mbikëqyrja e bazuar në rrezik kërkon lloje të ndryshme të informacioneve, të cilat trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet t'i marrë nga burimet ekzistuese, aty ku është e mundur. Aty ku nevojitet rimbikëqyrja konkrete, ai duhet të dizajnohet me kujdes dhe të fokusohet në marrjen e informacioneve lidhur me rreziqet kryesore që shqetësojnë trupin e mbikëqyrjes pensionale.

5.8 Aty ku përdoren veglat e vlerësimit sasior të rrezikut, modelet e përfshira duhet të dizajnohen me kujdes dhe kufizimet e tyre duhet të kuptohen plotësisht.

5.9 Modelet e vlerësimit të rrezikut duhet të pasqyrojnë fokusin e rrezikut të trupit të mbikëqyrjes pensionale (siç nxitet nga qëllimet dhe resurset e tij), dhe rrezikun neto të subjektit të vetëm relevant dhe faktorët sistematikë të rrezikut. Këta faktorë duhet të vlerësohen në mënyrë të përshtatshme sipas karakterit të sistemit pensional (duke përfshirë madhësinë dhe numrin e fondeve pensionale të mbikëqyrura) dhe vlerësimin e rrezikut që rezulton nga gjasat dhe ndikimi i paraqitjes së tyre.

Parimi 6: Proporcionaliteti dhe konsekuenca

Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të sigurojnë që kërkesat hetimore dhe zbatuese të jenë proporcionale me rreziqet që lehtësohen dhe që aktivitetet e tyre të jenë konsekuente

⁷Siç theksohet në Pakon e Veglave të IOPS-së për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik (www.iopstoolkit.org), mbikëqyrja e bazuar në rrezik (MBRR) është qasje e strukturuar që fokusohet në identifikimin e rreziqeve potenciale me të cilat përballen planet ose fondet pensionale dhe vlerësimin e faktorëve të përcaktuar financiarë dhe operativë për të minimizuar dhe zbutur rreziqet e tilla. Ky proces më pas i mundëson trupit të mbikëqyrjes pensionale t'i përqendrojë resurset e tij drejt çështjeve dhe subjekteve që paraqesin kërcënimin më të madh.

⁸Për më shumë detaje shih Pakon e Veglave të IOPS-së për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik (www.iopstoolkit.org) dhe *Udhëzimet e IOPS-së për ndërhyrjen mbikëqyrëse, zbatimin dhe sanksionet* <http://www.iopsweb.org/dataoecd/47/40/43972432.pdf>

6.1 Është e nevojshme të bëhet lidhja logjike midis rezultateve të vlerësimit të rrezikut të ndërmarrë nga trupi i revizionit pensional dhe aktiviteteve të tij (për shembull nëpërmjet përdorimit të matricës për përgjigjen mbikëqyrëse)⁹. Aktivitetet korigjuuese, dhe nëse është e nevojshme, sanksionet e vendosura nga trupi i revizionit pensional duhet të jenë në proporcion me lartësinë e rrezikut që e bart fondi për anëtarët dhe shfrytëzuesit e tij të sistemit pensional në tërësi, duke e marrë parasysh natyrën, vëllimin, kompleksitetin dhe seriozitetin e parregullsive potenciale në harmonizimin që i referohen palës relevante, dhe duhet të paraqes përdorim më efikas të resurseve mbikëqyrëse¹⁰. Natyra afatgjatë e fondeve pensionale duhet të merret parasysh, ndërsa sjellja e panevojshme prociklike duhet të shmanget.

6.2 Shkalla e kërkesave mbikëqyrëse të vendosura mbi fondet ose planet pensionale dhe palët e lidhura që mbikëqyrën duhet të jetë në pajtim me vlerën që pritet të rrjedhë prej tyre. Gjatë procesit të miratimit të vendimeve, duhet të arrihet ekuilibri midis përfitimeve potenciale të aktiviteteve mbikëqyrëse dhe shpenzimeve dhe ndikimit tek anëtarët dhe shfrytëzuesit e fondit pensional dhe, kur është e përshtatshme, sponsorët e planeve.

6.3 Pasi të identifikohet problemi, duhet të ndiqet "procesi juridik" i qartë dhe i përkufizuar mirë. Procesi juridik i përshkruan kontrollimet dhe ekuilibrat që duhet t'i vendos trupi mbikëqyrës për të siguruar që subjektet e mbikëqyrura trajtohen në mënyrë të drejtë, të qëndrueshme dhe transparente.

6.4 Për të siguruar proporcionalitet, kërkesat duhet të përcaktohen në rregullativën ligjvënëse, sekondare ose udhëzimet e detajuara të industrisë (që i theksojnë rrethanat e ndryshme dhe rrezikun, si dhe masat e ndërhyrjes që lidhen me to). Është e nevojshme të rregullohet ose të sigurohet dokumentacioni, udhëzimet dhe shembujt përkatës për personalin.

6.5 Përgjigjja, lënda e disponueshmërisë së autorizimeve dhe masave rregullatore dhe administrative, duhet të përshkallëzohet në mënyrë përkatëse për të arritur qëllimet e dëshiruara rregullatore. Në varësi të natyrës, shkallës dhe kompleksitetit të problemit të zbuluar, duhet të jepet përgjigje ose të merren masat e jashtëzakonshme.

6.6 Në përmbushjen e autorizimeve të tij mbikëqyrëse, trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të mundësojë fleksibilitet për fondet dhe planet pensionale, aty ku është e përshtatshme, në mënyrën në të cilën arrihet harmonizimi me kërkesat rregullatore.

6.7 Vendimet dhe ndërhyrjet mbikëqyrëse duhet të jenë konsistente (si horizontalisht ndërmjet fondeve pensionale, ashtu edhe vertikalisht me kalimin e kohës), duke i marrë parasysh në mënyrë përkatëse rrethanat e çdo rasti veçmas. Mbikëqyrësit duhet të kenë procedura të dokumentuara mirë (për shembull, dokumentacioni, trajnimi, recensionin nga kolegët, kontrollimet e ekipit të specialistëve dhe/ose mbikëqyrja e lartë) për të siguruar që vendime të ngjashme miratohen në rrethana të ngjashme dhe këto vendime merren në bazë objektive dhe të paanshme.

Parimi 7: Konsultimi dhe bashkëpunimi

Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të konsultohen me trupat që i mbikëqyrin dhe të bashkëpunojnë me trupat e tjerë mbikëqyrës kombëtarë dhe ndërkombëtarë

7.1 Trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të konsultohet, siç është në mënyrë përkatëse, me sektorin pensional kur e përcakton qasjen e tij ndaj mbikëqyrjes¹¹.

⁹Për detaje të mëtejshme shih Pakon e Veglave të IOPS-së për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik.

¹⁰Udhëzimet e IOPS-së për vlerësimin mbikëqyrës të fondeve pensionale
<http://www.iopsweb.org/dataoecd/38/47/41042660.pdf?contentId=41042661>

¹¹Për detaje të mëtejshme shih Udhëzimet e IOPS-së për ndërhyrjen mbikëqyrëse, zbatimin dhe sanksionet
<http://www.iopsweb.org/dataoecd/47/40/43972432.pdf>

7.2 Trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të autorizohet të shkëmbejë informacione me autoritetet e tjera mbikëqyrëse relevante, që janë lëndë e kërkesave ligjore dhe konfidenciale. Kjo përfshin bashkëpunimin me organet ose departamentet e tjera të përfshira në mbikëqyrjen pensionale (për shembull sjelljen e mbikëqyrësve të punës) në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (veçanërisht ku përfshihen pensionet tejkufitare), si dhe me organet që mbikëqyrin institucionet e tjera financiare relevante ose tregjet dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. Bashkëpunimi duhet të jetë për të arritur efikasitet në të dy qëllimet (të shmanget përputhja dhe përparimi i ekonomive në aspekt të vëllimit dhe fushëveprimit), si dhe promovimi i masave parandaluese proaktive (për shembull, përballja me krimin financiar).

7.3 Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të sigurojnë koordinim të përforcuar ndërmjet sektorëve financiarë dhe, kur është e nevojshme, në nivel ndërkombëtar, dhe veçanërisht në periudhat e vështirësive ekonomike dhe paqëndrueshmërisë së sistemeve financiare, duke i përmbushur kërkesat e konfidencialitetit.

Parimi 8: Konfidencialiteti

Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të veprojnë në mënyrë përkatëse me informacionet konfidenciale

8.1 Mbikëqyrësi pensional duhet të publikojë informacione konfidenciale vetëm nëse lejohet me ligj (me dënime në të holla, madje edhe me dënime me burg të shqiptuara për kundërvajtje). Personalit duhet të obligohet me kodet e brendshme të konfidencialitetit, madje edhe pas pushimit nga puna tek ai trup.

8.2 Sistemet e TI-së që i përdorin mbikëqyrësit duhet të përfshijnë qasje të kufizuar me qëllim të mbrohet konfidencialiteti dhe të ofrohet kujdesi i veçantë për sigurinë e bazës së të dhënave të trupit të mbikëqyrjes pensionale në mënyrë që të mundësohet mbrojtja efektive e të dhënave.

8.3 Trupi mbikëqyrës duhet të publikojë politikën e tij për faktin se sa informacione do të trajtohen si konfidenciale. Duhet të arrihet ekuilibri përkatës midis kryerjes së mbikëqyrjes së punës (ku mund të zbulohen informacionet për të ndikuar në sjelljen e komunitetit të mbikëqyrur), mbikëqyrjes së kujdesshme (ku konfidencialiteti është i rëndësishëm për të mbrojtur interesat e subjekteve të caktuara nën mbikëqyrje) dhe integritetit të sistemit, sipas natyrës së sistemit pensional.

8.4 Mbikëqyrësi pensional, në lidhje me informacionet që nuk janë me karakter publik, kur do të kërkohet nga organi përkatës, do t'i mbajë informacionet konfidenciale dhe do të mbajë masa mbrojtëse përkatëse për mbrojtjen e informacioneve konfidenciale në pronësi të tij.

8.5 Aty ku nuk është i sigurt statusi i informacioneve, trupi mbikëqyrës duhet t'i trajtojë si konfidenciale, nëse ato nuk janë të disponueshme publikisht ose duhet ta kontrollojë statusin tek organi që i siguron informacionet.

8.6 Vetëm nëse miratohet nga organi që i siguron informacionet, trupi mbikëqyrës që mund t'ua transferojë informacionet konfidenciale trupave të tjerë mbikëqyrës ose agjencive të zbatimit të ligjit, me kusht që të kenë interesa të ligjshme mbikëqyrëse dhe standarde identike të mbrojtjes së konfidencialitetit.

8.7 Aty ku bëhet transferi i personalit ndërmjet trupit mbikëqyrës dhe sektorit privat, duhet të ekzistojnë mekanizmat për të siguruar mbrojtjen e informacioneve konfidenciale.

8.8 Palët e treta të cilëve trupi i mbikëqyrjes pensionale u ka caktuar detyrat mbikëqyrëse duhet t'u nënshtrihen të njëjtave kërkesa për konfidencialitet të cilave u nënshtrohet personeli i trupit të mbikëqyrjes pensionale.

Parimi 9: Transparenca

Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet ta kryejnë punën e tyre në mënyrë transparente

9.1 Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të miratojnë procese të qarta, transparente dhe konsistente mbikëqyrëse. Është e nevojshme të publikohen rregullat dhe procedurat e trupit të mbikëqyrjes pensionale dhe përditësimet e tyre. Trupi i mbikëqyrjes pensionale në përgjithësi duhet të funksionojë në mjedis transparent dhe duhet të sigurojë dhe të publikojë raport të rregullt, të paktën një herë në vit dhe në kohë, mbi zbatimin e politikës së tij, duke i shpjeguar qëllimet e tij dhe duke e përshkruar performancën e tij në arritjen e këtyre qëllimeve.

9.2 Trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet t'u nënshtrohet kërkesave të rregullta të revizionit dhe njoftimit të cilat mundësojnë vlerësim për faktin se sa mirë trupi i përmbush përgjegjësitë e tij, duke siguruar që autorizimet dhe funksionet e trupit të mbikëqyrjes pensionale mos të ndryshohen në baza ad hoc.

9.3 Aty ku është e përshtatshme, veçoritë kryesore të çdo kornize të përgjigjes mbikëqyrëse (si për shembull piramida e realizimit)¹², duhet të shpallet publikisht nga trupi mbikëqyrës në mënyrë që veprimet e tij të kuptohen mirë dhe mos të jenë të papritura nga subjektet e mbikëqyrura.

9.4 Gjatë orientimit ose zëvendësimit të menaxhimit të fondeve ose planeve pensionale, trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet t'i shpjegojnë dhe të japin njoftim përkatës për arsyet e aktivitetit mbikëqyrës¹³.

9.5 Është e nevojshme të vendoset mekanizmi për zbulimin transparent të informacioneve dhe publikimin në kohë të vendimeve për ndërhyrje dhe sanksione, aty ku është e përshtatshme, që do të jetë lëndë e kërkesave përkatëse të konfidencialitetit.

9.6 Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të ofrojnë dhe publikojnë rregullisht informacione të qarta dhe të sakta për industrinë pensionale dhe publikun e gjerë, siç është gjendja financiare e industrisë së fondeve pensionale dhe njohurive mbi lëvizjet e mëdha në sektorin pensional. Dhënia e informacioneve shpjeguese në përgjithësi do të bëhet në baza të përgjithshme, por mund të jetë edhe për fondet pensionale individuale, dhe në atë rast rregullat e konfidencialitetit mund të jenë veçanërisht relevante.

Parimi 10: Menaxhimi

Trupi mbikëqyrës duhet t'u përmbahet praktikave të tij të menaxhimit të mirë, duke i përfshirë edhe kodet e menaxhimit, sistemet e brendshme të menaxhimit të rrezikut dhe matjen e performancave dhe duhet të jetë përgjegjës në këtë aspekt

10.1 Trupat mbikëqyrës duhet të vendosin dhe të veprojnë sipas praktikave të besueshme të menaxhimit, me qëllim që të ruajnë besueshmërinë dhe autoritetin moral për të shpallur praktika të mira të subjekteve nën mbikëqyrjen e tyre¹⁴.

10.2 Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të mbikëqyren nga këshilli drejtues me madhësi të përshtatshme. Rrogat e drejtorëve të lartë të trupit mbikëqyrës mund të publikohen për qëllimet e transparencës.

¹²Për detaje të mëtejshme shih *Pakon e Veglave të IOPS-së për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik* www.iopstoolkit.org

¹³Për detaje të mëtejshme shih *Udhëzimet e IOPS-së për ndërhyrjen mbikëqyrëse, zbatimin dhe sanksionet* <http://www.iopswb.org/dataoecd/47/40/43972432.pdf>

¹⁴Menaxhimi i mirë i trupave të mbikëqyrjes pensionale mund të përmblihet në katër kategori: **pavarësia**: nevojitet shpjegimi i përgjegjësive dhe autorizimeve të trupit, proceseve për emërimin e këshillit të tij drejtues dhe aftësinë për të siguruar resurse dhe për të vepruar pa ndikim të panevojshëm; **përgjegjësia**: përfshirja e revizioneve të jashtme, organizimi përkatës i brendshëm dhe matja e performancave; **transparenca**: sigurimi se qëllimet dhe arritjet e trupit kuptohen dhe se është vendosur lidhja konsultative me industrinë; **integriteti**: nevojiten kodet e sjelljes, diskrecioni për zbatimin e autorizimeve, kontrollet e brendshme dhe personaliteti kompetent.

10.3 Trupi i mbikëqyrjes pensionale duhet të vendoset dhe t'i përmbahet kodit të menaxhimit, në të cilin do të theksohen kontrollat e brendshme dhe bilanci përkatës, si dhe proceset efektive të menaxhimit të rrezikut dhe performancave. Duhet të vendoset kodi i sjelljes dhe ai duhet të zbatohet për të gjithë anëtarët e personalit.

10.4 Revizioni i brendshëm duhet të konsiderohet praktikë e mirë për trupat e mbikëqyrjes pensionale, i cili e shikon konsistencën dhe transparencën e procesit të miratimit të vendimeve, efektivitetin e praktikave të menaxhimit të rrezikut dhe efikasitetin dhe përdorimin përkatës të resurseve. Këto revizione të brendshme duhet të kryhen si pjesë e mbikëqyrjes juridike dhe funksionale të trupave mbikëqyrës dhe konstatimet e tyre duhet t'i prezantohen këshillit drejtues, i cili e mbikëqyr ministrinë (përkatëse) ose trupin tjetër statutar.

10.5 Duhet të ekzistojnë procedura të dokumentuara qartë për miratimin e vendimeve, me proceset për referimin e vendimeve deri në nivelin përkatës të kompetencës, i cili i shqyrton dhe dokumenton vendimet.

10.6 Për ndërhyrjet me ndikim serioz duhet të ekzistojë ndarja e caktuar midis atyre brenda organit që propozojnë ndërhyrje dhe atyre që e miratojnë vendimin përfundimtar, në mënyrë që hapësira për veprime urgjente të balancohet nga procesi i shqyrtimit.

10.7 Si pjesë e praktikave të sundimit të mirë, trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet t'i ndjekin performancat e tyre, duke përdorur një sërë masash.

10.8 Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të jenë qartësisht përgjegjës për sjelljen dhe aktivitetin e tyre të përgjithshëm nëpërmjet aranzhmaneve të përgjegjësive, të cilat do të dallohen në varësi të rrethanave konkrete të vendeve dhe që mund të përfshijnë përgjegjësinë ndaj një sërë trupash, nga parlamenti ose kreu i shtetit, Ministria e Financave deri tek anëtarët dhe shfrytëzuesit e fondeve ose planeve pensionale.

10.9 Trupat e mbikëqyrjes pensionale duhet të jenë lëndë e revizionit të jashtëm nga institucioni shtetëror ose institucioni i pavarur i revizorit.

10.10 Duhet të vendosen procedurat që trupi drejtues i planit ose fondit pensional të parashtrijë ankesë te trupi i mbikëqyrjes pensionale ose tribunali relevant për vendimet e miratuara nga trupi i mbikëqyrjes pensionale që u përkasin atyre dhe që konsiderojnë se janë të paarsyeshme ose të paharmonizuara me dispozitat ligjore. Anëtarët individualë të personalit të trupit mbikëqyrës duhet të dëmshpërblehen nga ndjekja civile¹⁵.

¹⁵Për detaje të mëtejshme shih *Udhëzimet e IOPS-së për ndërhyrjen mbikëqyrëse, zbatimin dhe sanksionet*
<http://www.iopsworld.org/dataoecd/47/40/43972432.pdf>